

**RAPORTI I MONITORIMIT VJETOR PËR**  
**KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2023**

---

**I. LISTA E PËRMBAJTJES SË RAPORTIT TË MONITORIMIT**

- HYRJE
  
- INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR
  
- PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE,  
NË NIVEL PRODUKTI
  
- PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVEL PROGRAMI
  
- PROJEKTET KAPITALE



**RAPORTI I MONITORIMIT VJETOR PËR**  
**KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2023**

**II. HYRJJE**

Mbështetur në ligjin 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, ligjit nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", udhëzimit nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” me anë të këtij raporti informojmë efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për Vitin 2023 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Viti 2023 ishte vit zgjedhor, dhe pikërisht më 14 Maj 2023 u zhvilluan zgjedhjet vendore, ku zgjedhësit zgjedhën kryetarët e bashkive dhe këshilltarët për 61 bashkitë e Shqipërisë.

Zgjedhjet vendore u menaxhuan nga një administratë zgjedhore me tre nivele, e cila përbëhet nga KQZ-ja, 92 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe 5211 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Numërimi kryhet nga Grupet e Numërimit (GN) në 92 Vende të Numërimit të Votave.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjatë vitit 2023, administroi dhe menaxhoi fondet publike sipas 2 programeve të miratuara:

I- Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrimi”

II- Programi “Zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore”

Në zbatim të ligjit nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023" i ndryshuar, plani i rishikuar i buxhetit për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në shumën 2,979,750,000 lekë, është detajuar sipas zërave:

- i. Shpenzime korrente 2,256,860,933 lekë
- ii. Shpenzime kapitale me financim të brendshëm 627,889,067 lekë
- iii. Shpenzime kapitale me financim të huaj 95,000,000 lekë

*Theksojmë se rreth 87.3 % e fondeve të akorduara për Komisionin Qendror të zgjedhjeve, ose 2.6 miliardë lekë janë dhe u përdorën me efektivitet në masën 97 %, për organizimin e zgjedhjeve vendore të datës 14 Maj 2023 si dhe për kryerjen e dy proceseve të tjera zgjedhore të rëndësishme (të cilat ishin të paparashikuara në buxhetin 2023), në shumën 41,4 milion lekë konkretisht:*

1. Zgjedhjet Rrogozhinë në shumën 15,9 milion lekë
2. Zgjedhjet Kukës në shumën 25,5 milion lekë

Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2023, sipas programeve buxhetore për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

**në lekë**

Titulli	Emri i Programit	Buxheti fillestar 2023	Buxheti i rishikuar 2023	Fakti 12 mujour	Realizimi %
				viti 2023	
1610	Planifikim Menaxhim Administrim	233,800,000	379,750,000	347,673,268	92
1620	Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale	0	2,600,000,000	2,521,652,201	97
<b>Totali i shpenzimeve KQZ 2023</b>		<b>233,800,000</b>	<b>2,979,750,000</b>	<b>2,869,325,469</b>	<b>96</b>

**III. INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR**

- Gjatë vitit 2023, plani i buxhetit për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, pësoi ndryshime nëpërmjet 5 Vendimeve të Këshillit të Ministrave, 1 Akt Normativ, 1 miratim i fondit të veçantë

## RAPORTI I MONITORIMIT VJETOR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2023

---

dhe 2 rialokime. Theksojmë se devijimi kryesor dhe më i rëndësishëm është akordimi i fondeve buxhetore në shumën 2.6 miliardë lekë në zbatim të VKM Nr.38, datë 27.01.2023 fonde të cilat u përdorën në masën 97% për realizimin e funksionit dhe qëllimit kryesor të KQZ-së, organizimin e zgjedhjeve vendore të 14 Majit për vitin 2023.

- **Ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në planin përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli në mënyrë të detajuar paraqitet:**

1. Në zbatim të VKM Nr.38, datë 27.01.2023 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023” miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”, në programin 01620 “Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në shkresat nr. 1898/2, datë 01.02.2023 dhe nr.2108/1, datë 07.02.2023 *miratoi fondet për organizimin e zgjedhjeve vendore, të datës 14 Maj 2023 në shumën 2,600,000,000 lekë*
2. Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.4528, datë 07.03.2023 “Dërgohet miratimi i fondit të veçantë për vitin 2023”, për KQZ u miratua fondi në shumën 250,000 lekë. Si rrjedhojë buxheti në dispozicion për programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim” për vitin 2023 është 234,050,000 lekë.
3. Në zbatim të VKM-së Nr. 325/2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në shkresën nr.12447/1, datë 18.07.2023 “Akordim fondi për rritjen e pagave për vitin 2023” akordoi fondet në programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim” 01610, për shpenzime personeli të cilat u shtuan për shumën 21.700.000 lekë, ndër të cilat 18.000.000 lekë për paga dhe 3.700.000 lekë për sigurime shoqërore.
4. Në zbatim të VKM-së Nr. 437, datë 19.07.2023 “Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në shkresën nr.13869/1, datë 31.07.2023 “Akordim fondi për rritjen e pagave të magjistratit për vitin 2023” akordoi fondet në programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim” 01610, në llogarinë 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” në shumën 5.500.000 lekë.
5. Në zbatim të Aktit Normativ nr.5, datë 18.10.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", Ministria e Financave dhe Ekonomisë në shkresat nr. 19139/65, datë 06.11.2023 dhe nr. 19139/81, datë 13.11.2023 akordoi fondet në programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim” 01610, në llogarinë 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” në shumën 9.000.000 lekë, si dhe 95.000.000 lekë në llogarinë 231 kapitulli 02, në këtë program.
6. Në zbatim të VKM-së 755, datë 20.12.2023 "Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione të pavarura të krijuara me ligj", Ministria e Financave dhe Ekonomisë në shkresën nr.23937, datë 29.12.2023 “Mbi zbatimin e VKM-së nr.755, datë 20.12.2023” akordoi fondet në programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim” 01610, në llogarinë 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” në shumën 13.000.000 lekë.
7. Në zbatim të VKM Nr.795, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të acquis (screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në shkresën nr.889/1, datë 15.01.2024 “Mbi zbatimin e VKM-së nr.795, datë 28.12.2023” akordoi fondet në programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim” 01610, në llogarinë 600 paga në shumën 1.500.000 lekë.



**RAPORTI I MONITORIMIT VJETOR PËR**  
**KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2023**

- Numri i rialokimeve të miratuara për vitin 2023 është 2 dhe paraqitet si më poshtë:
- 8. Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.20517/1, datë 15.11.2023 “Transferim fondi për vitin 2023”, për KQZ u miratua transferimi i fondit për shumën 500.000 lekë nga llogaria ekonomike 600 paga, në llogarinë ekonomike 601 sig shoqërore, në programin 01610.
- 9. Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9770/1, datë 07.06.2023 “Transferim fondesh për shpenzime kapitale” në programin “Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale” 01620, u shtua llogaria 230 “studim projektim” me shumën 49.266.240 lekë, shumë për të cilën u pakësua llogaria 231 “investime”

Në përfundim, buxheti i rishikuar i KQZ-së për periudhën raportuese janar – Dhjetor 2023 është 2,869,325,469 lekë.

- Numri i punonjësve buxhetorë i miratuar në ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", për institucionin e KQZ-së është 95, teksa numri faktik i punonjësve për vitin 2023 është 87. Devijimi i numrit faktik nga ai i planifikuar vjen për shkak të mosplotësimit të vendeve vakante në KQZ, edhe pse janë kryer të gjitha procedurat përkatëse për rekrutimin e punonjësve.

**Në fund të vitit 2023, për KQZ situata e realizimit të shpenzimeve të buxhetit krahasuar me planin 2023 me ndryshime, sipas të dhënave të gjeneruara nga SIFQ, paraqitet si më poshtë:**

**ANEKSI nr.1 Raporti Përmblledhës i Shpenzimeve të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve**

Periudha e Raportimit: 12-2023											në/lekë	
Emri i Grupit / Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Kodi i grupit	Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit										
		Viti parashikës 2022		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Ndryshimi i Vjetor (Plan-Fakt)	% e realizimit	
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2023	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2023	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive			Struktura e shpenzimeve në %
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7(5-3)	(8)	(9)	10(5-9)	11(8/5)		
<b>Shpenzimet sipas programeve buxhetore</b>												
Kodi i Programit	Emërtimi											
01610	Vepimtaria administrative e institucionit	227,408,777	55	233,800,000	100	379,750,000	13	145,950,000	347,673,268	9	32,076,732	69
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	183,109,158	45	0	0	2,600,000,000	87	2,600,000,000	2,521,652,201	91	78,347,799	97
	<b>Totali i Shpenzimeve buxhetore të KQZ</b>	<b>410,517,935</b>	<b>100</b>	<b>233,800,000</b>	<b>100</b>	<b>2,979,750,000</b>	<b>100</b>	<b>2,745,950,000</b>	<b>2,869,325,469</b>	<b>100</b>	<b>110,424,531</b>	<b>93</b>
	Shpenzime nga te Ardhurat jashte limitit (Kap06)	0							72,000			
	<b>Totali Shpenzimeve të Ministrisë</b>	<b>410,517,935</b>							<b>2,869,397,469</b>			
<b>Shpenzimet sipas Klasifikimit ekonomik</b>												
Artikulli	Emërtimi											
600	Paga	140,924,693	34	111,300,000	48	449,264,877	15	337,964,877	424,207,300	15	25,057,577	94
601	Sigurime Shoqërore	17,489,917	4	17,000,000	7	36,015,844	1	19,015,844	34,989,914	1	1,025,930	97
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	167,494,224	41	43,460,000	19	1,703,290,212	57	1,659,830,212	1,637,777,432	59	65,512,780	96
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferata Korrente të Brendshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
605	Transferata Korrente të Huaja	0	0	300,000	0	300,000	0	0	0	0	300,000	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	38,874,184	10	40,240,000	17	67,990,000	2	27,750,000	67,743,187	2	246,813	100
	<b>Non-Totali Shpenzime Korrente</b>	<b>364,793,018</b>	<b>89</b>	<b>212,300,000</b>	<b>91</b>	<b>2,256,860,933</b>	<b>76</b>	<b>2,044,560,933</b>	<b>2,164,717,834</b>	<b>78</b>	<b>92,143,099</b>	<b>96</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	49,266,240	2	49,266,240	49,266,240	2	0	100
231	Kapitale të Trupëzuara	45,724,917	11	21,500,000	9	578,622,827	19	557,122,827	568,941,396	20	9,681,431	98
	<b>Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm</b>	<b>45,724,917</b>	<b>11</b>	<b>21,500,000</b>	<b>9</b>	<b>627,889,067</b>	<b>21</b>	<b>606,389,067</b>	<b>618,207,636</b>	<b>22</b>	<b>9,681,431</b>	<b>99</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	95,000,000	3	95,000,000	86,400,000	0	8,600,000	91
	<b>Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>95,000,000</b>	<b>3</b>	<b>95,000,000</b>	<b>86,400,000</b>	<b>0</b>	<b>8,600,000</b>	<b>91</b>
	<b>Totali Shpenzime Kapitale</b>	<b>45,724,917</b>	<b>11</b>	<b>21,500,000</b>	<b>9</b>	<b>722,889,067</b>	<b>24</b>	<b>701,389,067</b>	<b>704,607,636</b>	<b>22</b>	<b>18,281,431</b>	<b>97</b>
	<b>Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit</b>	<b>410,517,935</b>	<b>100</b>	<b>233,800,000</b>	<b>100</b>	<b>2,979,750,000</b>	<b>100</b>	<b>2,745,950,000</b>	<b>2,869,325,469</b>	<b>100</b>	<b>110,424,531</b>	<b>96</b>
	<b>Buxhetor</b>											
	<b>Numri i punonjësve</b>	<b>95</b>		<b>95</b>		<b>95</b>			<b>87</b>			

**IV. PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE, NË NIVEL PRODUKTI, OBJEKTIVI**

Në 1 prej programeve të KQZ-së janë të paraqitur tregues performance me bazë gjinore, në nivel objektiv, atë të “Planifikim, menaxhim, administrimit”:

- a. % e grave në poste drejtuese të institucionit ndaj totalit të posteve drejtuese është 59%
- b. Numri i rasteve të diskriminimit me bazë gjinore në institucion të trajtuara është 0 %

Vlerat e realizimeve të këtyre produkteve janë paraqitur më poshtë sipas programit respektiv.

**RAPORTI I MONITORIMIT VJETOR PËR**  
**KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2023**

Treguesit e performancës në nivel qëllimi		Treguesit e performancës/Produktet:					
Kodi i treguesit	Emërtimi i treguesit	Tregues me bazë gjinore (PO)	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	Fakti i Periudhës/progresive	Ndryshimi (Plan - Fakt)	% e realizimit
Objektivat e politikës së programit							
Objektivi	Permirësimi dhe sigurimi i kushteve optimale të punës dhe rritje e kapaciteteve profesionale të punonjësve						
	% e grave në poste drejtuese të institucionit ndaj totalit të posteve drejtuese	Po	59%	59%	59%	0%	
	Numri i rasteve të diskriminimit me baze gjinore në institucion të trajtuara	Po	0	0	0	0	

**V. PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVEL PROGRAMI**

Një analizë më e detajuar e treguesve të monitorimit të buxhetit sipas programeve buxhetore paraqitet më poshtë:

**V.1 PROGRAMI 01610 - PLANIFIKIM MENAXHIM ADMINISTRIM**

Qëllimi i Politikës së Programit është:

“Perdorimi me efektivitet dhe efikasitet i burimeve njerëzore, mjeteve monetare me qëllim krijimin e kushteve sa më të mira të punës për trupën e KQZ-së dhe administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Objektivi i Politikës së Programit është:

Permirësimi dhe sigurimi i kushteve optimale të punës dhe rritje e kapaciteteve profesionale të punonjësve

- ✓ Ecuria e realizimit të shpenzimeve të programit është shumë e mirë, gjë që tregon se KQZ ka punuar për të përmbushur objektivat, për të realizuar produktet e përfituara të cilat kanë qënë të parashikuara në program, duke përdorur me efikasitet dhe efektivitet fondet buxhetore të akorduara për çdo zë shpenzimesh.

Ky program përbën 12.8% të totalit të shpenzimeve të KQZ-së për vitin 2023.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2023 për këtë program krahasuar me planin vjetor është 92% dhe sipas zërave kryesorë rezulton si më poshtë:

✓ Shpenzime korente	92%
✓ Shpenzime kapitale	90%
✓ Total Programi	92%

- ✓ *Ecuria e shpenzimeve të programit sipas klasifikimit ekonomik:*

**i. Shpenzime personeli [paga dhe sigurime shoqërore] për vitin 2023**

përfshin pagat dhe sigurimet shoqërore referuar organigramës dhe nivelit të pagave të miratuara dhe organikës prej 95 punonjës të aparatit të KQZ-së, për rritjen e performancës së administratës, në funksion të realizimit të objektivave të institucionit, në zbatim të kërkesave ligjore, si dhe krijimin e kushteve optimale në këtë institucion, konkretisht:

✓ buxheti i rishikuar është	151,500,000 lekë
✓ realizimi i buxhetit për vitin 2023 është	149,602,700 lekë
✓ realizimi në %	99%

**ii. Shpenzime mallra dhe shërbime 602 për vitin 2023:**

Përfshin shpenzimet për blerjen e mallra dhe shërbimeve lidhur me mirëfunksionimin e KQZ-së.

✓ buxheti i rishikuar është	43,460,000 lekë
-----------------------------	-----------------

**RAPORTI I MONITORIMIT VJETOR PËR**  
**KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2023**

---

- ✓ realizimi i buxhetit për vitin 2023 është 25,241,621 lekë
- ✓ realizimi në % 58 %

*Mosrealizimi në këtë zë vjen si rezultat kursimeve nga një pjesë e procedurave të prokurimit.*

**iii.** Shpenzime për Transferta Korente Të Huaja 605 për vitin 2023:

Transferta Korente të Huaja përfshin kuotën e anëtarësimit vjetor pranë Shoqata Botërore e Trupave të Menaxhimit të Zgjedhjeve (AËEB),

- ✓ buxheti i rishikuar është 300,000 lekë
- ✓ realizimi i buxhetit për vitin 2023 është 0 lekë
- ✓ realizimi në % 0 %

*Mosrealizimi në këtë zë vjen si pasiguri në vitin 2023 për shkak të riorganizimit të kësaj shoqate nuk u bë pagesë kuote anëtarësimi (nuk u paraqit një faturë nga shoqata).*

**iv.** Shpenzime Transferta për Buxhete Familjare & Individë 606 për vitin 2023:

- ✓ buxheti i rishikuar është 67,990,000 lekë
- ✓ realizimi i buxhetit për vitin 2023 është 67,743,187 lekë
- ✓ realizimi në % 100 %

Transferta për Buxhete Familjare & Individë është zëri i shpenzimeve nga i cili bëhen pagesat për...

1. Shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Rregullator, Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve. Llogaritja e fondeve është bërë në përputhje me parashikimin e nenit 12 të Kodit Zgjedhor të RSH. Këtu janë planifikuar 67.7 milion lekë dhe janë realizuar 67.5 milion lekë ose 100% % e fondeve të planifikuara në këtë zë.
2. Shpërblimet të cilat përfitojnë nga fondi i veçantë për pensione të ndryshme. Këtu janë planifikuar 250 mijë lekë dhe janë realizuar 232.8 mijë lekë ose 93% % e fondeve të planifikuara në këtë zë.

**v.** Shpenzime kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj 230-231 për vitin 2023:

- ✓ buxheti i rishikuar është 116,500,000 lekë
- ✓ realizimi i buxhetit për vitin 2023 është 105,085,760 lekë
- ✓ realizimi në % 90.2%

*Mosrealizimi prej 9.8 % ka të bëjë me faktin që për një pjesë të projekteve të investimeve janë lidhur kontratat në vlerë më të vogël se fondi limit.*

**1.** Shpenzime kapitale me financim të brendshëm, investime 01:

- ✓ buxheti i rishikuar është 21,500,000 lekë
- ✓ realizimi i buxhetit për vitin 2023 është 18,865,760 lekë
- ✓ realizimi në % 87 %

**2.** Shpenzime kapitale me financim të huaj (Grant), investime 02:

- ✓ buxheti i rishikuar është 95,000,000 lekë
- ✓ realizimi i buxhetit për vitin 2023 është 86,400,000 lekë
- ✓ realizimi në % 91 %



**RAPORTI I MONITORIMIT VJETOR PËR  
KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2023**

✓ *Performanca e shpenzimeve të programit sipas produkteve:*

*në lekë*

Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Buxheti 2023	Fakti 12 mujor 2023
97301AA	Administrata profesionale	151,750,000	149,835,500
97301AB	Ambiente pune te mirembajtura	43,760,000	25,241,621
97301AC	Akte nënligjore të miratuara dhe ankime të trajtuara	67,740,000	67,510,387
18AC301	Pajisje informatike dhe zyresh	15,000,000	13,705,760
23AC001	Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar; mbështetje e KQZ-së ç GRANT	95,000,000	86,400,000
M730058	Blerje makine	6,500,000	4,980,000
T	Total	379,750,000	347,673,268

- **Produkti "Administrata profesionale"** është realizuar në masën 99%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, ndërsa në terma sasiorë është realizuar në masën 95%
- **Produkti "Ambiente pune të mirëmbajtura"** është realizuar në masën 58%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, ndërsa në terma sasiorë është realizuar në masën 70%
- **Produkti "Akte nënligjore të miratuara dhe ankime të trajtuara"** është realizuar në masën 100%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, edhe në terma sasiorë është realizuar në masën 100%
- **Produkti "Pajisje informatike dhe zyresh"** është realizuar në masën 92%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, ndërsa në terma sasiorë është realizuar në masën 100%
- **Produkti "Blerje Mjete transporti"** është realizuar në masën 77%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, ndërsa në terma sasiorë është realizuar në masën 100%
- **Produkti "Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar; mbështetje e KQZ-së GRANT"** është realizuar në masën 91%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, ndërsa në terma sasiorë është realizuar në masën 100%

**ANEKSI nr. 2 Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit**

Periudha e Raportimit: 12-2023 në lekë

Emri i Grupit		Komisioni Qendror i Zgjedhjeve		Kodi i grupit		73		Emri i Grupit		Kodi i grupit		01610	
Emri i		Veprimtaria administrative e institucionit		Kodi i programit		01610		Emri i		Kodi i programit		01610	
EMËRTIME	Viti pararendës 2022	Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Ndryshimi i planit vjetor	Ndryshimi i planit vjetor	Ndryshimi i planit vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Shpenzime Faktive	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Filjestar Vjetor Viti 2023	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Risikuar Viti 2023	Struktura e shpenzimeve në %	Shpenzime Faktive të Periudhës së Progressit	Struktura e shpenzimeve në %				
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7 (5-3)	(8)				
<b>Shpenzimet sipas Masifitimit ekonomik</b>													
Kodi i Programit	Emërtimi												
600	Paga	99,259,640	99	111,300,000	99	130,800,000	99	19,500,000	129,760,102	99	1,039,898	99	
601	Sigurime Shoqërore	15,150,000	96	17,000,000	96	20,700,000	96	3,700,000	19,842,598	96	857,402	96	
602	Mallradhe Shërbimet të tjera	28,400,036	58	43,460,000	58	43,460,000	58	0	25,241,621	58	18,218,379	58	
605	Transferata Korrente të Huaja	0	0	300,000	0	300,000	0	0	0	0	300,000	0	
606	Transp. Buxh. Fam. & Individ	38,874,184	100	40,240,000	100	67,990,000	100	27,750,000	67,743,197	100	246,813	100	
	<b>Nëntotali Shpenzime Korrente</b>	<b>181,683,860</b>	<b>92</b>	<b>212,300,000</b>	<b>92</b>	<b>263,250,000</b>	<b>92</b>	<b>50,950,000</b>	<b>242,587,508</b>	<b>92</b>	<b>20,662,492</b>	<b>92</b>	
230	Kapitaletë Patruçizues	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
231	Kapitaletë Trupëzues	45,724,917	87	21,500,000	87	21,500,000	87	0	18,685,760	87	2,814,240	87	
	<b>Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm</b>	<b>45,724,917</b>	<b>87</b>	<b>21,500,000</b>	<b>87</b>	<b>21,500,000</b>	<b>87</b>	<b>0</b>	<b>18,685,760</b>	<b>87</b>	<b>2,814,240</b>	<b>87</b>	
230	Kapitaletë Patruçizues	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
231	Kapitaletë Trupëzues	0	0	0	0	95,000,000	0	95,000,000	86,400,000	0	8,600,000	91	
	<b>Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>95,000,000</b>	<b>0</b>	<b>95,000,000</b>	<b>86,400,000</b>	<b>0</b>	<b>8,600,000</b>	<b>91</b>	
	<b>Totali Shpenzimeve Korrente</b>	<b>45,724,917</b>	<b>16</b>	<b>21,500,000</b>	<b>16</b>	<b>116,500,000</b>	<b>16</b>	<b>95,000,000</b>	<b>105,085,760</b>	<b>87</b>	<b>11,414,240</b>	<b>90</b>	
	<b>Totali Shpenzimeve Buxhetore të Programit</b>	<b>227,408,777</b>	<b>69</b>	<b>233,800,000</b>	<b>69</b>	<b>379,750,000</b>	<b>69</b>	<b>145,950,000</b>	<b>347,673,268</b>	<b>69</b>	<b>32,076,732</b>	<b>92</b>	
	<b>Totali Shpenzimeve të Programit</b>	<b>227,408,777</b>				<b>379,750,000</b>			<b>347,673,268</b>			<b>92</b>	
<b>Shpenzimet sipas produkteve të programit buxhetor</b>													
Artikulli	Emërtimi												
	<b>Totali Shpenzime Korrente</b>	<b>181,683,860</b>	<b>80</b>	<b>212,300,000</b>	<b>91</b>	<b>263,250,000</b>	<b>69</b>	<b>50,950,000</b>	<b>242,587,508</b>	<b>93</b>	<b>20,662,492</b>	<b>92</b>	
Kodi i produktit	Emërtimi												
97301AA	Administrata profesionale	115,549,105	51	128,300,000	55	151,750,000	40	23,450,000	149,835,500	57	1,914,500	99	
97301AB	Ambiente pune te mirembajtura	28,400,036	13	43,760,000	19	43,760,000	12	0	25,241,621	10	18,518,379	58	
97301AC	Akte nënligjore të miratuara dhe ankime të trajtuara	37,734,719	17	40,240,000	17	67,740,000	18	27,500,000	67,510,387	26	229,613	100	
	<b>Totali Shpenzime për investime</b>	<b>45,724,917</b>	<b>20</b>	<b>21,500,000</b>	<b>9</b>	<b>116,500,000</b>	<b>31</b>	<b>95,000,000</b>	<b>105,085,760</b>	<b>7</b>	<b>11,414,240</b>	<b>90</b>	
Kodi i produktit	Emërtimi												
18AC301	Pajisje informatike dhe zyresh	5,743,068	3	15,000,000	6	15,000,000	4	0	13,705,760	5	1,294,240	91	
M730058	Blerje makine	0	0	6,500,000	3	6,500,000	2	0	4,980,000	2	1,520,000	77	
	<b>Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm</b>	<b>45,724,917</b>	<b>20</b>	<b>21,500,000</b>	<b>9</b>	<b>21,500,000</b>	<b>6</b>	<b>0</b>	<b>18,685,760</b>	<b>7</b>	<b>2,814,240</b>	<b>87</b>	
Kodi i produktit	Emërtimi												
23AC001	Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar; mbështetje e KQZ-së	0	0	0	0	95,000,000	25	95,000,000	86,400,000	0	8,600,000	91	
	<b>Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>95,000,000</b>	<b>25</b>	<b>95,000,000</b>	<b>86,400,000</b>	<b>0</b>	<b>8,600,000</b>	<b>91</b>	
	<b>Totali Shpenzimeve të Programit</b>	<b>227,408,777</b>		<b>233,800,000</b>		<b>379,750,000</b>		<b>145,950,000</b>	<b>347,673,268</b>		<b>32,076,732</b>	<b>92</b>	



**RAPORTI I MONITORIMIT VJETOR PËR**  
**KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2023**

---

**V.2 PROGRAMI 01620 - “ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME DHE VENDORE”**

Qëllimi i Politikës së Programit është:

“KQZ synon caktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqytjen si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet”

Objektivi i Politikës së Programit është:

Garantimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, ku qytetarët të shprehin vullnetin e tyre të lirë, në bazë të një procesi të duhur administrativ, pa ndërhyrje politike dhe sipas standardeve.

- ✓ *Ecuria e realizimit të shpenzimeve të programit* është shumë e mirë gjë që tregon se KQZ ka punuar për të përmbushur objektivat, për të realizuar produktet e përfituara të cilat kanë qënë të parashikuara në program, duke përdorur me efikasitet dhe efektivitet fondet buxhetore të akorduara për çdo zë shpenzimesh.

Ky program përbën 87.3% të totalit të shpenzimeve të KQZ-së për vitin 2023.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2023 për këtë program krahasuar me planin vjetor është 97%, sipas zërave kryesorë rezultojnë si më poshtë:

✓ Shpenzime korente	96%
✓ Shpenzime kapitale	99%
✓ <b>Total Programi</b>	<b>97%</b>

- ✓ *Ecuria e shpenzimeve të programit sipas klasifikimit ekonomik:*

**1. Shpenzime personeli [paga dhe sigurime shoqërore] për vitin 2023**

Përfshin Paga, sigurime shoqërore/shëndetësore për punonjësit me kontratë të përkohshme si dhe pagesat e komisionerëve të KZAZ, QV e GNV, dhe e trajnerëve, etj, buxheti i rishikuar është

✓ buxheti i rishikuar është	333,780,721 lekë
✓ realizimi i buxhetit për vitin 2023 është	309,594,514 lekë
✓ realizimi në %	93 %

1,612,535,811

**2. Shpenzime mallra dhe shërbime 602 për vitin 2023:**

✓ buxheti i rishikuar është	1,659,830,212 lekë
✓ realizimi i buxhetit për vitin 2023 është	1,612,535,811 lekë
✓ realizimi në %	97 %

**3. Shpenzime kapitale me financim të brendshëm investime 230-231 për vitin 2023:**

✓ buxheti i rishikuar është	606,389,067 lekë
✓ realizimi i buxhetit për vitin 2023 është	599,521,876 lekë
✓ realizimi në %	99 %





# RAPORTI I MONITORIMIT VJETOR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2023

ANEKSI nr. 2 Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit

në lekë

Emri i Grupit		Komisioni Qendror i Zgjedhjeve		Kodi i grupit		73						
Emri i		Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale		Kodi i programit		01620						
EMËRTIME	Shpenzimet e Programit							Ndryshimi i planit vjetor	Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit		
	Viti paraardhës 2022	Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese						
	Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2023	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i lëshuar Viti 2023	Struktura e shpenzimeve në %	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progressive				Struktura e shpenzimeve në %	
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7 (5-3)	(8)	(9)	10 (8-8)	11 (8/5)		
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik												
Kodi i Programit	Emërtimi											
600	Paga	41,665,053	93	0	93	318,464,877	93	318,464,877	294,447,198	93	24,017,679	93
601	Sigurime Shoqërore	2,349,917	99	0	99	15,315,844	99	15,315,844	15,147,316	99	168,528	99
602	Mallradhe Shërbimetë Tjera	139,094,188	97	0	97	1,659,830,212	97	1,659,830,212	1,612,535,811	97	47,294,401	97
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferata Korrentetë Brendshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
605	Transferata Korrentetë Huaja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
606	Trans per Buxh, Fam. & Individ	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>Nëntotali Shpenzime Korrente</b>	<b>183,109,158</b>	<b>96</b>	<b>0</b>	<b>96</b>	<b>1,993,610,933</b>	<b>96</b>	<b>1,993,610,933</b>	<b>1,922,130,325</b>	<b>96</b>	<b>71,480,608</b>	<b>96</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	100	0	100	49,266,240	100	49,266,240	49,266,240	100	0	100
231	Kapitale të Trupëzuara	0	99	0	99	557,122,827	99	557,122,827	550,255,636	99	6,867,191	99
	<b>Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm</b>	<b>0</b>	<b>99</b>	<b>0</b>	<b>99</b>	<b>606,389,067</b>	<b>99</b>	<b>606,389,067</b>	<b>599,521,876</b>	<b>99</b>	<b>6,867,191</b>	<b>99</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>Totali i Shpenzimeve Kapitale</b>	<b>0</b>	<b>99</b>	<b>0</b>	<b>99</b>	<b>606,389,067</b>	<b>99</b>	<b>606,389,067</b>	<b>599,521,876</b>	<b>99</b>	<b>6,867,191</b>	<b>99</b>
	<b>Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit</b>	<b>183,109,158</b>	<b>97</b>	<b>0</b>	<b>97</b>	<b>2,600,000,000</b>	<b>195</b>	<b>2,600,000,000</b>	<b>2,521,652,201</b>	<b>195</b>	<b>78,347,799</b>	<b>97</b>
Shpenzimet sipas produkteve të programit buxhetor												
Artikulli	Emërtimi											
	<b>Totali i Shpenzimeve Korrente</b>	<b>183,109,158</b>	<b>100</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,993,610,933</b>	<b>77</b>	<b>1,993,610,933</b>	<b>1,922,130,325</b>	<b>76</b>	<b>71,480,608</b>	<b>96</b>
Kodi i produktit	Emërtimi											
97302AA	Proces zgjedhor i realizuar	183,109,158	100	0	0	1,993,610,933	77	1,993,610,933	1,922,130,325	76	71,480,608	96
	<b>Totali i Shpenzimeve për Investime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>606,389,067</b>	<b>23</b>	<b>606,389,067</b>	<b>599,521,876</b>	<b>24</b>	<b>6,867,191</b>	<b>99</b>
Kodi i produktit	Emërtimi											
22AF701	Infrastruktura TIK Qendrore KQZ	0	0	0	0	66,971,067	3	66,971,067	65,083,876	3	1,887,191	97
22AF702	Server Terciar per backup	0	0	0	0	980,000	0	980,000	0	0	980,000	0
22AF703	Modem për transmetimin e te dhënave	0	0	0	0	3,848,000	0	3,848,000	3,848,000	0	0	100
22AF801	Blerje pajisje PEVN (hardware) për 352 Qendra Votimi	0	0	0	0	528,360,000	20	528,360,000	528,360,000	21	0	100
22AF901	Transportuese paletash elektrike Forklift	0	0	0	0	4,000,000	0	4,000,000	0	0	4,000,000	0
22AF902	Restaurim i magazines nr.4 (magazina e paisjeve PEI)	0	0	0	0	2,230,000	0	2,230,000	2,230,000	0	0	100
	<b>Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>606,389,067</b>	<b>23</b>	<b>606,389,067</b>	<b>599,521,876</b>	<b>24</b>	<b>6,867,191</b>	<b>99</b>
Kodi i produktit	Emërtimi											
	<b>Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>Totali i Shpenzimeve të Programit</b>	<b>183,109,158</b>	<b>97</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2,600,000,000</b>	<b>195</b>	<b>2,600,000,000</b>	<b>2,521,652,201</b>	<b>195</b>	<b>78,347,799</b>	<b>97</b>

✓ Performanca e shpenzimeve të programit sipas produkteve:

*në lekë*

Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Buxheti 2023	Fakti 12 major 2023
97302AA	Proces zgjedhor i realizuar	1,993,610,933	1,922,130,325
22AF701	Infrastruktura TIK Qendrore KQZ	66,971,067	65,083,876
22AF702	Server Terciar per backup	980,000	0
22AF703	Modem për transmetimin e te dhënave	3,848,000	3,848,000
22AF801	Blerje pajisje (hardware) PEVN.	528,360,000	528,360,000
22AF901	Transportuese paletash elektrike Forklift	4,000,000	0
22AF902	Restaurim i magazines nr.4 (magazina e paisjeve PEI)	2,230,000	2,230,000
T	Total	<b>2,600,000,000</b>	<b>2,521,652,201</b>

- **Produkti "Proces zgjedhor i realizuar"** është realizuar në masën 97%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, ndërsa në terma sasiorë është realizuar në masën 100%
- **Produkti "Infrastruktura TIK Qendrore KQZ"** është realizuar në masën 97%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, ndërsa në terma sasiorë është realizuar në masën 100%
- **Produkti "Server Terciar per backup"** është realizuar në masën 0%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023.
- **Produkti "Modem për transmetimin e te dhënave"** është realizuar në masën 100%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, edhe në terma sasiorë është realizuar në masën 100%
- **Produkti "Blerje pajisje (hardëare) PEVN"** është realizuar në masën 100%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, edhe në terma sasiorë është realizuar në masën 100%
- **Produkti "Transportuese paletash elektrike Forklift"** është realizuar në masën 0%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023.
- **Produkti "Restaurim i magazines nr.4 (magazina e paisjeve PEI)"** është realizuar në masën 100%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, edhe në terma sasiorë është realizuar



**RAPORTI I MONITORIMIT VJETOR PËR**  
**KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2023**

*në masën 100%.*

**VI. PROJEKTET KAPITALE**

**1. PROGRAMI 01610 - PLANIFIKIM MENAXHIM ADMINISTRIM**

*Realizimi i shpenzimeve kapitale për periudhën Janar-Dhjetor 2023 për KQZ është 90 % e planit për vitin 2023.*

*në lekë*

Kodi Produktit	Planifikim Menaxhim Administrim	Buxheti i rishikuar 2023	Fakti 12 mujor	Realizimi %
			viti 2023	
	<b>Investime me financim të brendshëm 01</b>	<b>21,500,000</b>	<b>18,685,760</b>	<b>87</b>
18AC301	Paisje informatike dhe zyre	15,000,000	13,705,760	91
M730058	Blerje Mjete transporti [Fugona]	6,500,000	4,980,000	77
	<b>Investime me financim të huaj 02</b>	<b>95,000,000</b>	<b>86,400,000</b>	<b>91</b>
23AC001	“Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar; mbështetje e KQZ-së” GRANT	95,000,000	86,400,000	91
<b>Totali i shpenzimeve kapitale 01+02 KQZ 2023</b>		<b>116,500,000</b>	<b>105,085,760</b>	<b>90</b>

**2. PROGRAMI 01620 - “ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME DHE VENDORE”**

*Realizimi i shpenzimeve kapitale për këtë program, për periudhën Janar-Dhjetor 2023 është 99 % e planit për vitin 2023.*

Kodi Produktit	Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale	Buxheti i rishikuar 2023	Fakti 12 mujor	Realizimi %
			viti 2023	
22AF901	Transportuese paletash elektrike Forklift	4,000,000	0	0
22AF702	Server Terciar per backup	980,000	0	0
22AF902	Restaurim i magazines nr.4 (magazina e paisjeve PEI)	2,230,000	2,230,000	100
22AF701	Infrastruktura TIK Qendrore KQZ	66,971,067	65,083,876	97
22AF801	Blerje pajisje (hardware)PEVN.	479,093,760	479,093,760	100
22AF801	Liçensa per software per 760 PEVN dhe permiresimi i SEMVR	49,266,240	49,266,240	100
22AF703	Modem për transmetimin e te dhënave	3,848,000	3,848,000	100
	<b>Investime me financim të brendshëm 01</b>	<b>606,389,067</b>	<b>599,521,876</b>	<b>99</b>

**RAPORTI I MONITORIMIT VJETOR PËR**  
**KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2023**

---

***Të dhënat e raportuara të buxhetit të rishikuar dhe realizimi faktik përkojnë plotësisht me të dhënat e gjeneruara nga sistemi SIFQ deri në 31 Dhjetor 2023.***

Paraqitja e informacionit si dhe të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit janë në përputhje me përcaktimet të bëra në Udhëzimin nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, dhe anekseve të përcaktuara në këtë udhëzim bashkëlidhur:

- ANEKSI nr. 1 “Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve”
- ANEKSI nr.1.1 “Raporti i Shpenzimeve të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve sipas kapitujve”
- ANEKSI nr. 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Institucioni Buxhetor"
- ANEKSI nr. 2 “Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit”
- ANEKSI nr. 2.1 “Shpenzimet e programit sipas kapitujve”
- ANEKSI nr. 3 “Raporti i performancës së produkteve të programit”
- ANEKSI nr. 3.1 “Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve”
- ANEKSI nr. 3.2 “Deviacioni kostos për njësi në vite”
- ANEKSI nr. 4 “Raporti i realizimit të treguesve të performances së programit”

